

U D H Ë Z I M
Nr.17, datë 29.12.1993

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1, DATË 29.1.1993
“PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE”

Në zbatim të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N :

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 29.1.1993 pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:

“Qytetarët që kanë statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar për privatizimin e banesave duhet të paraqesin në komisionet e privatizimit këto dokumente:

a) Raportim mjeko-ligjor i lëshuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP), në të cilin personi deklarohet invalid lufte dhe me grupin përkatës.

b) Dëshmia e invaliditetit, e cila duhet të ketë firmën dhe vulën e organit drejtues të shoqatës e të organit financiar të vendbanimit të invalidit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi